

Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë

Seria e dokumenteve të punës mbi duhanin

Albulena Xhelili Berisha, PhD
Besnik Prekazi, MA
Democracy Plus

Korrespondencë me: Besnik Prekazi, Democracy Plus
Email: besnik@dlpus-ks.org

Citime të sugjeruara:

Berisha, A. & Prekazi, B. (2023). Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë (Dokument pune mbi Tobakonominë nr.23/8/1). Tobakonomia. www.tobacconomics.org/research/fillimi-duhani-duhani-ndër-rininë-në-kosovë-seri-letër-pune-duhani/

Mirënjohje:

Demokrasi Plus financohet nga Instituti për Kërkime dhe Politika Shëndetësore (UIC) i Universitetit të Illinois në Çikago për realizimin e hulumtimeve ekonomike mbi tatimimin e duhanit në Kosovë. UIC është partner i Iniciativës së Filantropisë Bloomberg për reduktimin e konsumit të duhanit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen dhe nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë pikëpamjet e UIC, Institutit për Kërkime dhe Politika Shëndetësore, ose Filantropisë Bloomberg.

Fjalët kyçe:

Fillimi i duhanpirjes, pirja e duhanit nga të rinjtë, çmimet e cigares, konsumimi i duhanit

Kodet JEL: H2, H3, I10, I18

Abstrakt

Informata të përgjithshme

Gati 50 për qind e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçe. Përderisa popullsia e saj rinore konsiderohet si një nga pasuritë më të mëdha të vendit, ajo mund të jetë edhe thembër e Akilit kur bëhet fjalë për konsumin e duhanit. Sipas Anketës Botërore të Duhanpirjes të Rinjtë (GYTS) për vitin 2016, shkalla e duhanpirjes të rinjtë (mosha 13-15) në Kosovë është rreth 9 për qind, 11.7 për qind për djemtë dhe 5.6 për qind për vajzat. Dëshmitë nga shtete të ndryshme tregojnë se tatimimi i duhanit dhe rritja e çmimeve janë mënyrat më efektive për të dekurajuar konsumimin e duhanit. Ky hulumtim shqyrton përcaktuesit e ndryshëm të fillimit të duhanpirjes të rinjtë në Kosovë, duke përfshirë edhe çmimin e duhanit.

Metodologjia

Për të shqyrtuar sjelljen e duhanpirjes së rinjve në Kosovë, në këtë hulumtim janë përdorur të dhënat nga GYTS 2016. Fillimi i duhanpirjes është modeluar si funksion i çmimeve të cigareve, masave të kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin, si dhe variablave socio-ekonomikë. Hulumtimi aplikon teknika të analizës së mbijetesës dhe modele të kohëzgjatjes së ndarjes së popullsisë (SPD), ku probabiliteti i fillimit modelohet si funksion i variablave të ndryshëm. Duke e ndarë popullsinë në ata që përfundimisht fillojnë duhanpirjen ata që nuk fillojnë, si dhe duke vlerësuar shkallën e rrezikut të fillimit të pjesës tjetër të popullsisë, modeli SPD përlllogarit mundësinë që disa individë të mos pinë kurrë duhan.

Grupi i të dhënave transformohet në një format pseudo-gjatësor duke përdorur informacionin mbi moshën e fillimit, e cila vetë-raportohet nga të anketuarit. Informacioni i kombinuar mbi moshën e të anketuarve në kohën e realizimit të anketës dhe mosha e tyre e raportuar kur kanë filluar duhanpirjen mundëson ndërtimin e një variabli mbi statusin e duhanpirjes për subjektet e vëzhguara gjatë tërë periudhës, duke siguruar kështu të dhëna nga ekspozimi i parë të rinjve në duhanpirje e deri te viti i fillimit të duhanpirjes, si për ata të anketuar që përfundimisht fillojnë duhanpirjen, apo dështojnë, ashtu edhe për ata që nuk dështojnë gjatë asaj periudhe. Për të ndërtuar masa për çmimet e cigareve, ne përdorim përgjigjet e vetë-deklaruar për të dhënat që kanë të bëjnë me çmimin në GYTS dhe të dhënat zyrtare të raportuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Rezultatet

Rezultatet e hulumtimit sugjerojnë se çmimi, qasja e lehtë në cigare, ekspozimi të prindërit dhe bashkëmoshatarët duhanpirës, gjinia dhe mosha janë përcaktues të rëndësishëm të fillimit të duhanpirjes për të rinjtë e Kosovës. Çmimi është përcaktues i fortë negativ i fillimit të duhanpirjes për të rinjtë kosovarë. Ka një rënie prej 65 për qind të rrezikut të pritshëm në raport me një rritje të çmimit prej një për qind, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante. Për femrat duhanpirëse të reja në Kosovë, shkalla e pritshme e rrezikut (duke supozuar rritje prej një për qind të çmimit) është 58.1 për qind më e ulët se ajo për meshkujt e rinj, që është statistikiht e rëndësishme.

Qasja në cigare është një tjetër përcaktues i rëndësishëm i sjelljes së duhanpirjes te të rinjtë e Kosovës. Rezultatet sugjerojnë se rreziku i pritshëm është 286 për qind më i lartë për të anketuarit të cilët e kanë mjaft të lehtë të blejnë cigare, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante. Mjedisi social gjithashtu duket të jetë faktor i rëndësishëm në sjelljen e duhanpirjes së të rinjve në Kosovë. Ka një rritje prej 129 për qind të rrezikut të pritshëm nëse gjysma e shokëve të të anketuarit pinë duhan, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante. Gjithashtu, kemi shqyrtuar nëse politikat kyçe të kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin e që janë zbatuar gjatë kësaj periudhe kanë pasur ndikim në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë, por rezultatet për masat e politikave kyçe të qeverisë nuk ishin të rëndësishme.

Përfundime

Ky hulumtim plotëson një boshllëk në literaturë në lidhje me sjelljen e duhanpirjes së të rinjve në Kosovë, si dhe ofron dëshmi se politikat tatimore/të çmimit që ulin përbalueshmërinë e cigareve mund të kenë ndikim të ndjeshëm në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë. Andaj, politikëbërësit në Kosovë duhet t'i hartojnë politikat e tyre tatimore të duhanit ashtu që aplikojnë rritje të mëdha dhe të rregullta për të siguruar vazhdimësi të normave të larta tatimore dhe çmimeve të larta, duke pasur parasysh se çmimi është përcaktues kyç i sjelljes së duhanpirjes te të rinjtë.

Fjalët kyçe: *Fillimi i duhanpirjes, duhanpirja te të rinjtë, çmimet e cigareve, konsumimi i duhanit*

Hyrje

Kostot e imponuara financiare dhe shëndetësore të konsumit të duhanit janë të faktuara mirë në literaturë, dhe fakti që shtetet me të ardhura të ulëta dhe të mesme do të bartin, në mënyrë joproportionale, barrën kryesore të këtyre kostove deri më 2030 (OBSH, 2011) ka nxitur nevo-

jën mbarëbotërore për politika të qarta që synojnë uljen e konsumit të duhanit. Meqë përdorimi i produkteve të duhanit fillon dhe vendoset kryesisht gjatë adoleshencës (Stoklosa et al., 2021), për Kosovën - si shtet me të ardhura të ulëta dhe me popullsinë më të re në Evropë - është jetik përcaktimi i faktorëve që nxisin fillimin e duhanpirjes.

Gati 50 për qind e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçe dhe rinia e saj, ndonëse konsiderohet si një nga pasuritë më të mëdha të vendit, mund të dëshmojë të jetë thembër e Akilit kur flitet për konsumimin e duhanit. Më 2016, të rinjtë (mosha 13-15) në Kosovë raportuan shkallë të duhanpirjes prej rreth 9 për qind (11.7 për qind për djemtë dhe 5.6 për qind për vajzat sipas Anketës Botërore të Duhanpirjes (GYTS) 2016. Kjo çështje është edhe më shqetësuese duke pasur parasysh se 22.4 për qind e duhanpirësve të rritur në Kosovë e kanë filluar duhanpirjen ndërmjet moshës 16 dhe 17 vjeçe (Prekazi & Pula, 2020), që do të thotë se të rinjtë që e fillojnë duhanpirjen në Kosovë e bëjnë këtë në moshë të re.

Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë është shqetësim serioz për shëndetin publik. Duhanpirja në moshë të re rrit gjasat që një person të vazhdojë të pijë duhan edhe në moshën madhore, duke shkaktuar probleme shëndetësore afatgjata. Këto probleme minojnë aftësinë e individit për të qenë ekonomikisht produktiv, duke dobësuar kolektivisht rritjen dhe prosperitetin e përgjithshëm të vendit. Prandaj, është me rëndësi që prindërit, edukatorët dhe politikëbërësit të ndër marrin hapa për të parandaluar që të rinjtë të fillojnë duhanpirjen dhe t'i ndihmojnë të rinjtë të shmangin rreziqet e përdorimit të duhanit.

Parandalimi i fillimit të duhanpirjes te të rinjtë është i rëndësishëm për shëndetin publik. Strategjitë efektive për parandalimin e fillimit të duhanpirjes te të rinjtë mund të jenë zbatimi i politikave të kontrollit të duhanit, si rritja e tatimit në cigare dhe kufizimi i marketingut të duhanit.

Rritja e tatimit në produktet e duhanit mund është mënyrë efektive për të reduktuar fillimin e duhanpirjes te të rinjtë. Hasse et al. (2015) zbuluan se çmimi më i lartë i cigareve ka korrelacion të fortë me uljen e gjasës të fillimit të duhanpirjes te të rinjtë. Gjithnjë e më shumë hulumtime janë duke zbuluar lidhje pozitive midis rritjes së çmimeve dhe ndërprerjes së duhanpirjes te të rinjtë (Towerk et al., 2010). Në përgjithësi, provat sugjerojnë se rritja e taksave për produktet e duhanit është mënyrë efektive për uljen e konsumin e duhanit te të rinjtë dhe për të përmirësuar shëndetin publik.

Efektiviteti i politikave që rrisin çmimin - duke ulur kështu shkallën e fillimit të duhanpirjes - raportohet të jetë më i lartë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (Chaloupka et al., 2011). Kjo është edhe më e theksuar te të rinjtë, të cilët, sipas dëshmive, janë më të ndjeshëm ndaj taksave të duhanit dhe rritjeve përkatëse të çmimeve (NCUDHS, 2021), kryesisht për shkak se të rinjtë zakonisht kanë të ardhura më të kufizuara.

Taksat më të larta të duhanit janë veçanërisht të rëndësishme për vendet me popullsi të re, siç është Kosova, të cilat synojnë të ulin konsumin e duhanit. Ky hulumtim shqyrton ndikimin e çmimeve të cigares në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë kosovarë dhe ofron njohuri për përdorimin e tatimit të duhanit si strategji për kontrollin e duhanit.

Literatura sugjeron gjithashtu se ekspozimi në duhanpirje të bashkëmoshatarëve dhe familjarëve, përmes miqve, prindërve dhe vëllezërve e motrave, është përcaktues i rëndësishëm i fillimit të duhanpirjes te të rinjtë (Dusenbury et al., 1992; Unger & Cheng, 1999; Fletcher, 2009; Lakon et al., 2010). Hulumtime të shumta empirike tregojnë se adoleshentët me prindër që janë duhanpirës janë me gjasë më të lartë të fillojnë duhanpirjen edhe ata (Gilman et al., 2009; Hill et al., 2005).

Krahas çmimit dhe ekspozimit ndaj duhanpirjes së bashkëmoshatarëve dhe familjarëve, ky hulumtim gjithashtu shqyrton ndikimin që kanë qasja në cigare, gjinia dhe politikat e ndryshme të kontrollit të duhanit të ndërmarra nga qeveria e Kosovës në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë kosovarë. Sipas njohurive tona, ky është hulumtimi i parë që shqyrton efektet e rritjes së çmimit të cigareve dhe politikave të tjera të kontrollit të duhanit në sjelljen e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë. Rezultatet e hulumtimit mund të jenë të vlefshme për qeverinë e Kosovës, për hartimin e iniciativave të ardhshme shëndetësore, politikave të kontrollit të duhanit dhe fushatave të ndërgjegjesimit për shëndetin publik kundër konsumimit të duhanit.

Pjesa tjetër e raportit është strukturuar si vijon: Kapitulli 2 përshkruan të dhënat e përdorura, burimet e tyre dhe statistikat përshkruese. Specifikimi i modelit është përshkruar në Kapitullin 3. Rezultatet empirike të vlerësimit dhe implikimet e tyre janë shtjelluar në Kapitullin 4. Kapitulli 5 paraqet konkluzat e hulumtimit.

Metodologjia

Të dhënat

Ky hulumtimi përdor të dhëna nga Anketat Botërore të Duhanpirjes te të Rinjtë (GYTS), komponent ky i Sistemit Global të Mbikëqyrjes së Duhanpirjes (GTSS), i cili është standard global për monitorimin sistematik të konsumimit të duhanit te të rinjtë (duhanpirja dhe duhani pa tym) dhe identifikimin e treguesve kryesorë të kontrollit të duhanit. GYTS përdor metodologji të standardizuar globale që përfshijn një model mostrimi me dy faza me shkollë të përzgjedhura me një probabilitet proporcional me nivelin e regjistrimit shkollor. Klasat brenda shkollave të përzgjedhura zgjidhen në mënyrë të rastësishme dhe të gjithë nxënësit në klasat e përzgjedhura kanë të drejtë të marrin pjesë në anketë.

Anketa përdor një pyetësor standard bazë me disa pyetje opsionale të cilat shtetet mund t'i përshtatin për të matur dhe gjurmuar treguesit kryesorë të kontrollit të duhanit. Anketa paraqet një hulumtim ndërsektorial, dhe është përfaqësuese në nivel vendi me bazë në shkolla, synim i së cilës janë nxënësit në klasat përkatës të moshës 13 -15 vjeçe.

GYTS e fundit në Kosovë është realizuar në vitin 2016 nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe përfshin një mostër prej 5,031 nxënës në klasat 7 deri 9, përfshirë 3,895 nxënës të moshës 13-15 vjeçe. Anketa raporton të dhëna vetëm për këta 3895 nxënës. Shkalla e përgjithshme e përgjigjes ishte 94.6 për qind.

Vlen të theksohet se një GYTS është realizuar më parë në Kosovë, në vitin 2004. Shkalla e përgjigjes në shkolla ishte 98.2 për qind, shkalla e përgjigjes së klasa ishte 100 për qind, shkalla e përgjigjes së nxënësve ishte 89 për qind dhe shkalla e përgjithshme e përgjigjes ishte 87.4 për qind. Gjithsej morën pjesë 2,444 nxënës të moshës 13 -15 vjeçe.


Ky studim raporton vetëm rezultatet e bazuara në GYTS të fundit të vitit 2016 meqë

është më i ri, por edhe për shkak se të dhënat e nevojshme të çmimeve nga ASK nuk janë në dispozicion nëse përdoret anketa e vitit 2004. Për më tepër, pyetjet nga të cilat janë ndërtuar variablat kyçe të interesit nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme ndërmjet dy anketave. Të dhënat pseudo-gjatësore të përdorura në këtë hulumtim përbëhen nga të dhënat GYTS të vitit 2016 dhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) që mbulojnë periudhën 2007-2017. Shumica e variablave rrjedhin nga linjat e përfshira në anketën GYTS dhe ASK, siç shihet në listën në Tabelën A1, në Shtojcë.

Fillimi i duhanpirjes. Variabli kryesor i varur i këtij hulumtimi është akti i fillimit të duhanpirjes, që rrjedh nga përgjigjet në pyetjen “Sa vjeç keni qenë kur provuat për herë të parë një cigare?” Në GYTS, kjo ishte pyetje me zgjedhje të shumëfishta, e cila nuk jep moshën e saktë të fillimit të duhanpirjes, por ofron një sërë kategorish nga mosha shtatë vjeçe ose më e re, deri në 16 vjeç e më lart. Mosha e fillimit kodohet si variabël i vazhdueshëm duke marrë pikën e mesit të çdo grupi si mosha e fillimit, që sugjeron se fillimi në këtë mostër ka ndodhur në moshat si në vijim: 7, 9, 11, 13, 15, apo 16.

Figura 1

Çmimi konstant i një pako cigaresh dhe forma e saj natyrale logaritmike



Çmimi i cigares. Variabli kryesor i pavarur i konsideruar në këtë hulumtim është çmimi i cigareve. Për të ndërtuar masa për çmimet e cigareve, kemi përdorur përgjigjet e vetë-deklaruara në të dhënat që kanë të bëjnë me çmimin në GYTS dhe të dhënat zyrtare të raportuara nga ASK në Raportin e tyre Vjetor mbi Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (CPI) për pako cigaresh Lucky Strike. Këto grupe të dhënash përdoren për të ndërtuar një masë konstante çmimi, siç tregohet në Figurën 1.

Zakonisht preferohet përdorimi i të dhënave zyrtare sepse ato konsiderohen më të paanshme, më të sakta dhe më të besueshme se të dhënat e anketës. Megjithatë, në një vend të vogël si Kosova, me çmime relativisht të unifikuara në rajone të ndryshme, vetëm përdorimi i të dhënave zyrtare mund të rezultojë në mungesë të variacionit, gjë që mund të rrezikojë vlerësimin e ndikimit të çmimit. Prandaj, janë përdorur të dhënat nga të dy burimet. Gjithashtu, kemi vlerësuar edhe reagimin e fillimit të duhanpirjes me ndërveprimin e çmimit sipas gjinisë.

Qasja në cigare. Gjithashtu kemi shqyrtuar nëse qasja në cigare ka ndikim në fillimin e duhanpirjes nga të rinjtë kosovarë. Këtë e kemi bërë duke përfshirë variabla të rremë që marrin vlerën një nëse i anketuari deklaroi se ishte mjaft lehtë për të blerë cigare dhe zero nëse i refuzuar ndonjëherë shitja e cigareve. Pritet gjasë më e lartë të fillimit nëse të anketuarit e kishin të lehta për t'i blerë cigaret dhe gjasë më të ulët të fillimit nëse raportojnë se iu është refuzuar blerja.

Politika e kontrollit të duhanit që nuk ka të bëjë me çmimin. Për të matur efektivitetin e politikës së kontrollit të duhanit që nuk ka të bëjë me çmimin në parandalimin e fillimit të duhanpirjes te të rinjtë kosovarë, kemi përfshirë variabla të "rremë" (eng. dummies) që kapin ndikimin e secilës politikë të rëndësishme gjatë tërë periudhës nën shqyrtim. Tri politikat kryesore që nuk kanë të bëjnë me çmimin e që janë zbatuar në Kosovë janë: 1) ligjet për akcizën e duhanit dhe përpun-

imin dhe tregtimin e prodhimit të miratuara më 2011, 2) ligji për kontrollin e duhanit i miratuar më 2013 dhe 3) akciza kalendarike e duhanit e miratuar më 2015. Ne përdorim variabla të rremë që marrin vlerën një kur secili prej këtyre ligjeve hyn në fuqi.

Kontrollet. Gjithashtu, kemi aplikuar kontrolle për karakteristikat demografike si gjinia dhe mjedisi social. Për të matur ndikimin e gjinisë dhe mjedisit social për sa i përket fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë, ne kemi përfshirë variabla të rremë që rrjedhin nga të dhënat e vetë-deklaruara. Këto të dhëna përfshijnë gjininë e të anketuarit, që merr vlerën zero nëse është mashkull dhe një nëse është femër; nëse njëri prej prindërve ka qenë duhanpirës, ku vlera është zero nëse asnjëri nuk pi duhan dhe një nëse njëri (ose të dy) pi duhan; dhe nëse së paku gjysma e miqve të afërt të të anketuarit pinë duhan, ku vlera është zero nëse më pak se gjysma pinë duhan dhe një nëse të paktën gjysma e miqve të afërt pinë duhan.

Metodat

Për hulumtimin e përcaktuesve të fillimit të duhanpirjes në Kosovë, për këtë hulumtim janë përdorur teknikat e analizës së mbijetesës dhe modelet e kohëzgjatjes së ndarjes së popullsisë. Probabiliteti i fillimit është modeluar si funksion i çmimit, politikave të tjera që nuk kanë të bëjnë me çmimin dhe karakteristikave socio-ekonomike dhe socio-biheviorale të të anketuarve.

Teknikat e analizës së mbijetesës janë përdorur në literaturë për të shqyrtuar kohën e akteve të ndryshme, siç është fillimi i duhanpirjes, duke supozuar se probabiliteti i fillimit afrohet te njëshi në momentin që rreziku bëhet i konsiderueshëm. Megjithatë, ato gjithashtu supozojnë se çdo subjekt i vëzhguar përfundimisht do të fillojë, që në rastin e duhanpirjes është sugjerim i paarsyeshëm, meqë ka individë që nuk do të fillojnë kurrë të pinë duhan, pavarësisht se sa kohë janë vëzhguar.

Për ta llogaritur këtë dinamikë, pas hulumtimit ekzistues, ne kemi aplikuar modelin e kohëzgjatjes së ndarjes së popullsisë (SPD) për të llogaritur mundësinë që disa individë nuk do të nisin të pinë duhan kurrë. Në këtë mënyrë, ne e kemi ndarë popullsinë në ata që përfundimisht e arrijnë aktin (pra fillojnë duhanpirjen) dhe ata që nuk e arrijnë. Kështu, ne mund t'i shfrytëzojmë të dhënat e individëve që nuk fillojnë duhanpirjen edhe gjatë periudhës kohore të vëzhguar, të cilat konsiderohen të censuruara.

Në modelin e ndarjes së popullsisë, një pjesë e popullsisë supozohet se nuk do të fillojë kurrë duhanpirjen dhe shkalla e rrezikut për fillimin është vlerësuar për pjesën tjetër të popullsisë. Kjo është metodologji e përdorur nga shumë studiues që hulumtojnë ndikimin e çmimit në fillimin e duhanpirjes (Kostova et al., 2015; Stoklosa et al., 2015; Gordon et al., 2019; Gonzalez-Rozada & Montamat, 2019).

Për këtë hulumtim është përdorur specifikimi vijues i modelit.

$$\begin{aligned} \ln(L) &= \sum \{c_i \ln[k * \int (t|s_i \\ &= 1, x_i(t))] \\ &+ (1 - c_i) \ln[1 - k + k \\ &* S(t|s_i = 1, x_i(t))]\} \end{aligned}$$

Ku L është kontributi i gjasës që personi i me kohë mbijetese prej t vjet; $c_i=1$ nëse i individual ka pirë duhan ndonjëherë; $s_i=1$ nëse i individual përfundimisht do të fillojë të pijë duhan dhe 0 nëse nuk do të fillojë kurrë; z_i janë bashkëvariartet e pandryshueshme në kohë dhe x_i janë bashkëvariarte që ndryshojnë në kohë; k është probabiliteti i duhanpirjes; $f(t|s_i=1, x_i(t))$ është funksioni i kushtëzuar i densitetit i fillimit të duhanpirjes në moshën fillestare të vëzhguar; dhe $k*S(t|s_i=1, x_i(t))$ është probabiliteti për të filluar pas moshës së vëzhguar në anketë.

Rreziku i duhanpirjes modelohet si funksion i çmimeve të cigareve, qasjes në cigare, politikave të kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmim dhe kontrolleve si gjinia, sjellja e prindërve duhanpirës dhe sjellja e bashkëmoshatarëve duhanpirës.

Rreziku = f (çmimi, qasja, politikat e kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin, kontrollet)

Për realizimin e hulumtimit, grupi i të dhënave transformohet në një format pseudo-gjatësor duke përdorur informacionin mbi metodat moshën e fillimit, e cila vetë-raportohet nga të anketuarit. Informacioni i kombinuar për moshën aktuale të të anketuarve në kohën e anketimit dhe moshën kur ata e kanë filluar duhanpirjen mundëson ndërtimin e variablit mbi statusin e duhanpirjes gjatë tërë periudhës.

Kështu, kemi informacion nga ekspozimi i parë deri në vitin e fillimit të duhanpirjes për pjesën e të anketuarve që përfundimisht e fillojnë duhanpirjen, ose dështojnë, dhe nga ekspozimi i parë deri në intervistë për ata që nuk dështojnë gjatë asaj periudhe.

Grupi i të dhënave pseudo-gjatësore është integruar me të dhënat për çmimin e cigareve të siguruar nga ASK. E kemi modeluar probabilitetin e dështimit eventual si më pak se një, për një pjesë të popullsisë, si dhe kemi përdorur një specifikim polinomi kub (t, t_2, t_3) si formë funksionale për varësinë e kohëzgjatjes në funksionin e rrezikut.


Rezultatet

Ky Kapitull paraqet rezultatet empirike për modelin e teknikave të specifikimit të analizës së mbijetesës dhe SPD, për të hulumtuar sjelljen e duhanpirjes së të rinjve në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i individëve të vëzhguar në mostër është 4.590. Shkalla e individëve që kanë filluar duhanpirjen është 22.8 për qind. Moshë mesatare e individëve

Figura 2

Vlerësimet e rrezikut kumulativ Nelson-Aalen sipas gjinisë



në momentin e fillimit është 11 vjeç. Nga personat që kanë filluar duhanpirjen në mostër (pra, që kanë dështuar), 61 për qind janë meshkuj dhe 38 për qind janë femra. Vetëm tre për qind e mostrës kanë filluar duhanpirjen në moshën tetë vjeç dhe rreth 12 për qind e kanë filluar në moshën 15 vjeç. Kohëzgjatja mesatare në mostër është 6.5 vjet. Kemi supozuar se mosha minimale e ekspozimit është tetë vjeç.

Për të analizuar se si ka evoluar popullsia me kalimin e kohës, kemi aplikuar analizën Nelson-Aalen dhe kemi nxjerrë kurbën e rrezikut kumulativ të fillimit të duhanpirjes në intervale të parregullta kohore, të cilat i dallojmë sipas gjinisë. Figura 2 tregon trendet e rreziqeve të fillimit të duhanpirjes sipas gjinisë dhe sugjeron që shkalla e rrezikut rritet me kalimin e kohës dhe se rreziqet janë më të ulëta për vajzat e reja në Kosovë sesa për djemtë e rinj. Rreziku rritet për të dyja gjinitë pas moshës tetë vjeç.

The values below one are interpreted to reduce the hazard of smoking by the distance to one, while those above one increase the hazard of smoking initiation by the amount greater than one. The change in hazard ratios from one is obtained by $[1-\exp(\cdot)]$. If the value <1 , then an increase in variable leads to a reduction of hazard ratios by $[1-\exp(\cdot)]$. If it is >1 , then an increase in variable leads to an increase in hazard ratio by $[1-\exp(\cdot)]$. For price, $[1- 0.345] = 0.65$.

Tabela 1.
Rezultatet kryesore

	Mostra e plotë		Femër		Mashkull	
Fillimi	Vlerësimi (t-stat.)	HR	Vlerësimi (t-stat.)	HR	Vlerësimi (t-stat.)	HR
Çmimi	-1.062** (-2.90)	0.345	-1.876** (-2.84)	0.153	-0.56 (-1.25)	0.571
Femër	-0.868*** (-9.15)	0.419				
Mosha	-0.176 (-1.14)	0.838	-0.429 (-1.52)	0.651	-0.025 (-0.13)	0.975
t	1.856*** (-5.66)		2.235*** (-3.31)		2.311*** (-5.4)	
t2	-0.221** (-3.28)		-0.233 (-1.69)		-0.387*** (-4.04)	
t3	0.014** (-3.06)		0.016 (-1.69)		0.026*** (-3.93)	
N	31,238		17,000		15,099	

Tabela e mësipërme tregon tre grupe kryesore të rezultateve dhe raportet e tyre të llogaritura të rrezikut (HR). Kjo është për shkak se, fillimisht, tek variablat shpjegues kemi përfshirë variablin e çmimit, një variabël moshe dhe një variabël të rremë si kontroll për gjininë; dhe më pas kemi kryer të njëjtin vlerësim për vajzat dhe djemtë ndaras.

Rezultatet sugjerojnë se variabli ynë kryesor i çmimit është statistikisht i rëndësishëm dhe ka ndikim të fortë në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë kosovarë. Raportet e rrezikut për variablat e çmimeve janë nën vlerën një, dhe ka rënie prej 65 për qind në rrezikun e pritshëm në krahasim me rritjen prej një për qind të çmimit, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Për ta thënë ndryshe, me një çmim mesatar prej 10 euro, rritja prej 10 për qind në çmim (ekuivalente me 0,2 euro) do të ulte rrezikun e fillimit të duhanpirjes me rreth 13 për qind (0,2 * 0,65). Natyrisht, me rritjen e çmimit,

rritet edhe ndikimi i vlerësuar i rritjes së çmimit prej 10 për qind; për shembull, me çmim mesatar prej 2.2 euro, rritja prej 10 për qind (0.22 euro) do të ulte rrezikun e fillimit të duhanpirjes për 14.3 për qind.

Rezultatet tregojnë se gjinia është gjithashtu parashikues i rëndësishëm i fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë. Vlerësimi për koeficientin e variablit femër është shumë domethënës, me efekt relativisht të konsiderueshëm. Mesatarisht, rezultatet sugjerojnë se rreziku i pritshëm është 58 për qind më i ulët tek femrat e reja krahasuar me meshkujt e rinj, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Përveç rezultateve tona kryesore, kemi vlerësuar modelin kryesor me variabla shtesë të kontrollit dhe kemi nxjerrë këto rezultate dhe raportet e tyre të rrezikut të llogaritur në Tabelën 2.

Fillimisht, te variablat shpjegues kemi përfshirë variablin e lehtësisë së qasjes në cigare

dhe variablat e politikës, më pas kemi shtuar një variabël kontrolli nëse së paku njëri nga prindërit është duhanpirës. Në modelin e mëposhtëm, kemi shtuar një kontroll për ndërveprimin e çmimit dhe variablit të rremë femëror, dhe në specifikimin përfundimtar kemi aplikuar edhe kontroll për zakonet e duhanpirjes të shokve të të anketuarve.

Specifikimet e modelit me termin e ndërveprimi të çmimit dhe variablit për femra sugjerojnë ndikim të ngjashëm të meshkujt dhe femrat.

Çmimi është përcaktues i fortë i fillimit të duhanpirjes në çdo specifikim.

Qasja në cigare është po ashtu përcaktues i rëndësishëm i sjelljes së duhanpirjes të rinjtë e Kosovës. Vlerësimi për koeficientin që ka të bëjë me variablat e lehtësisë së blerjes është statistikisht shumë i rëndësishëm dhe në përputhje me pritshmëritë e mëparshme. Qasja e lehtë pritet të rritë rrezikun e fillimit të duhanpirjes. Rezultatet sugjerojnë se rreziku i pritshëm është 286 për qind më i lartë për të anketuarit të cilët e kanë mjaft të lehtë të blejnë cigare, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Tabela 2.
Rezultatet shtesë

Fillimi	Vlerësim (t-stat.)	HR	Vlerësim (t-stat.)	HR	Vlerësim (t-stat.)	HR	Vlerësim (t-stat.)	HR
Çmimi	-1.239** (-3.15)	0.29	-1.308** (-3.28)	0.27	-1.389*** (-3.47)	0.25	-1.391*** (-3.47)	0.25
Femër	-0.635*** (-7.62)	0.53	-0.631*** (-7.61)	0.53	-1.698*** (-3-35)	0.18	-1.683*** (-3-33)	0.19
Mosha	-0.375* (-2.03)	0.69	-0.418* (-2.23)	0.66	-0.419* (-2.24)	0.66	-0.442* (-2.35)	0.64
t	1.768*** (-5.12)	5.86	1.812*** (-5.19)	6.12	1.804*** (-5.18)	6.07	1.816*** (-5.21)	6.15
t2	-0.168** (-2.71)	0.85	-0.170** (-2.72)	0.84	-0.167** (-2.68)	0.85	-0.168** (-2.70)	0.85
t3	0.00857* (-2.19)	1.01	0.00870* (-2.22)	1.01	0.00835* (-2.14)	1.01	0.00830* (-2.14)	1.01
Lehtësia e blerjes	1.349*** (-14.55)	3.85	1.332*** (-14.38)	3.79	1.308*** (-14.01)	3.70	1.231*** (-14.58)	3.42
Policy_2011	-0.32 (-1.39)	0.73	-0.33 (-1.45)	0.72	-0.33 (-1.43)	0.72	-0.34 (-1.50)	0.71
Policy_2013	0.16 (-0.86)	1.17	0.12 (-0.66)	1.13	0.13 (-0.67)	1.14	0.13 (-0.72)	1.14
Policy_2015	-0.02 (-0.11)	0.98	-0.03 (-0.21)	0.97	-0.04 (-0.23)	0.96	-0.04 (-0.21)	0.96
Një prind duhanpirës			0.13 (-1.66)	1.14	0.13 (-1.62)	1.14	0.09 (-1.24)	1.09
Female_CPrice					0.214* (-2.14)	1.24	0.218* (-2.21)	1.24
Miq duhanpirës							0.792*** (-5.87)	2.21
N	32,099		17,000		15,099		31,755	

t statistics in parentheses
*p<0.05, **p<0.01, p<0.001

Mosha është gjithashtu parashikues i rëndësishëm i fillimit të duhanpirjes për të rinjtë e Kosovës kur shtojmë variabla të ndryshëm kontrolli. Vlerësimi për koeficientin e variablit të moshës është domethënë, me nivel të rëndësisë prej 10 për qind me efekt relativisht të konsiderueshëm. Në mesatare, rezultatet sugjerojnë se rreziku i pritshëm ulet për 36 për qind te vajzat dhe djemt e rinj gjersa rriten në moshë, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Gjithashtu kemi hulumtuar nëse politikat kyçe të kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin e që janë zbatuar gjatë kësaj periudhe kanë pasur ndonjë fuqi shpjeguese në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë. Rezultatet sugjerojnë se ligjet e ndryshme të miratuara nuk kanë pasur një ndikim statistikor të rëndësishëm.

Tutje kemi hulumtuar nëse ekspozimi në duhanpirje në mjedis shtëpiak është faktor i rëndësishëm në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë kosovarë. Rezultatet sugjerojnë se ekspozimi në duhanpirje në shtëpi nuk ka ndikim statistikor të rëndësishëm. Gjithashtu, ndikimi nuk është i rëndësishëm në përmasa të mëdha dhe nuk ndikon ndjeshëm në rezultatet në çmim, që sugjeron që efekti i drejtpërdrejtë i çmimit në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë është i lartë dhe i fuqishëm.

Pastaj kemi shtuar variablin që kontrollon numrin e shokëve të të anketuarve që raportohen si duhanpirës në variablat shpjegues. Mjedi social gjithashtu duket të jetë faktor i rëndësishëm në sjelljen e duhanpirjes së të rinjve në Kosovë. Ka një rritje prej 129 për qind të rrezikut të pritshëm nëse gjysma e shokëve të të anketuarit pinë duhan, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante. Duke qenë se ky variabël mund të jetë potencialisht endogjen, ne kemi vlerësuar rezultatet me dhe pa këtë variabël dhe përfshirja e tij nuk ndikon në rezultatet e vlerësuar të variablave të tjerë.

Në fund, vlerësimet statistikor të rëndësishme të t , t_2 dhe t_3 sugjerojnë se modele

të ndryshme të rrezikut janë domethënëse në model.

Ashtu sikurse me hulumtimet e tjera të ngjashme, ky hulumtim është përballur me disa kufizime. Kufizimi kryesor është në ndërtimin e variablit të fillimit, i cili, së bashku me paragjykimin e rikujtimit, shkakton gabime në matje. Megjithatë, kjo llogaritet në termin e gabimit meqë ajo është variabla e varur në hulumtim. Për më tepër, paragjykimi i rikujtimit konsiderohet më i vogël, duke pasur parasysh se hulumtimi përdor anketë me të rinjtë dhe koha e rikujtimit është relativisht e shkurtër. Hulumtimi gjithashtu nuk bën dallim midis duhanpirësve aktualë dhe atyre të mëparshëm, meqë GYTS nuk ka shtruar pyetje për statusin aktual të duhanpirjes së të anketuarve. Anketa ka pyetur vetëm se kur të anketuarit e kanë provuar për herë të parë duhanin, gjë që mund të jetë çorientuese në kuptimin që disa individë provojnë të pinë duhan herët, por nuk janë aktualisht duhanpirës.

Për më tepër, modeli nuk merr parasysh variacionet e çmimeve ndërmjet brendeve të ndryshme dhe merr në konsideratë opionin më të lirë, duke supozuar se të rinjtë janë më me gjasë të pinë duhan të brendeve më të lira, sepse zakonisht janë më të ndjeshëm ndaj çmimeve sesa të rriturit.

Përfundime

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtohen përcaktuesit e fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë dhe të kontribuojë në literaturën ekzistuese mbi konsumimin e duhanit. Sjellja e duhanpirjes së të rinjve nuk është analizuar sa duhet në Kosovë dhe, sipas njohurive tona, ky është hulumtimi i parë që shqyrton efektet e rritjes së çmimit të cigareve dhe politikave të tjera të kontrollit të duhanit në sjelljen e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë.

Hulumtimi i fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë i modeluar si funksion i

çmimeve të cigareve, masave të kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin dhe variabla socio-ekonomikë dhe socio-bihejviorale është realizuar duke përdorur teknika të analizës së mbijetesës dhe modele të kohëzgjatjes së ndarjes së popullsisë, ku probabiliteti i fillimit është modeluar si funksion i variabla të ndryshëm.

Rezultatet tregojnë se çmimi është përcaktues i rëndësishëm i fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë dhe është më i theksuar te vajzat e reja. Për më tepër, rezultatet tregojnë se qasja e lehtë në cigare

rrit rrezikun e fillimit të duhanpirjes dhe se sjellja e prindërve dhe sjellja e bashkëmoshatarëve ndikon në vendimin për të filluar duhanpirjen te të rinjtë në Kosovë.

Si përfundim, hulumtimi plotëson një boshllëk në literaturë duke shqyrtuar sjelljen e të rinjve në fillimin e duhanpirjes në Kosovë. Hulumtimi ofron dëshmi se politikat tatimore/të çmimit dhe politikat e kontrollit të duhanit që nuk kanë të bëjnë me çmimin janë përcaktues të rëndësishëm të sjelljes së duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë.

Referencat

1. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). (2011). *Raporti i OBSH-së për epideminë globale të duhanit*. OBSH, Gjenevë.
2. Stoklosa, M., Pogorzelszyk, K., & Balwicki, Ł. (2021). *Mjetet për të reduktuar përdorimin e duhanit te të rinjtë në Poloni: Adresimi i përballueshmërisë dhe qasjes së produkteve të duhanit nëpërmjet taksave dhe masave të tjera*. Oslo: Shoqëria Norvegjeze e Kancerit.
3. Akademia GTSS. (2016). *Përdorimi i duhanit te të rinjtë në Kosovë*. Akademia GTSS. <https://www.gtssacademy.org/explore/country/Kosovo/#surveys-and-datasets>
4. Prekazi, B., & Pula, E. (2020). *Përdorimi i duhanit te të rriturit në Kosovë*. Demokraci Plus. Prishtinë, Kosovë. <https://tobacconomics.org/research/adult-tobacco-use-in-kosovo-report/>
5. Chaloupka, F. J., Straif, K., & Leon, M. E. (2011). Efektiviteti i politikave tatimore dhe çmimeve në kontrollin e duhanit, *Kontrolli i duhanit*, 20(3), 235-238. doi: 10.1136/tc.2010.039982
6. Instituti Kombëtar i Kancerit i SHBA dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë. *Ekonomia e Duhanit dhe Kontrolli i Duhanit*. Monografia 21-të e Institutit Kombëtar të Kancerit për Kontrollin e Duhanit. Publikimi i NIH Nr. 16-CA-8029A. Bethesda, MD: Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Kancerit; dhe Gjenevë, CH: Organizata Botërore e Shëndetësisë; 2016. <http://cancercontrol.cancer.gov/brp/tcrb/monographs/21/index.html>.
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës. (20XX). *Raport vjetor për indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit*. <https://ask.rks-gov.net/media/3312/cpi-hicp-2002-2016-english.pdf>
8. Barreto, S. M., de Figueiredo, R. C., & Giatti, L. (2013). Pabarazitë socio-ekonomike në duhanpirjen e të rinjve në Brazil. *BMJ Open*, 3(12), e003538. <https://doi.org/10.1136/bmjopen-2013-003538>
9. Distefan, J. M., Pierce, J. P., & Gilpin, E. A. (2004). A ndikojnë yjet e preferuar të filmit në fillimin e duhanpirjes tek adoleshentët? *Gazeta Amerikane e Shëndetit Publik*, 94(7), 1239-1244. <https://doi.org/10.2105/ajph.94.7.1239>
10. Dusenbury, L., Kerner, J. F., Baker, E., Botvin, G., James-Ortiz, S., & Zauber, A. (1992). Parashikuesit e prevalencës së duhanpirjes te të rinjtë latinë në Nju Jork. *Gazeta Amerikane e Shëndetit Publik*, 82(1), 55-58. <https://doi.org/10.2105/ajph.82.1.55>
11. Fletcher, J. M. (2010). Ndërveprimet sociale dhe pirja e duhanit: Dëshmi duke përdorur grupe të shumta nxënësish, variabla instrumentale dhe efekte fikse të shkollës. *Ekonomia e Shëndetit*, 19(4), 466-484. <https://doi.org/10.1002/hec.1488>
12. Gilman, S. E., Rende, R., Boergers, J., Abrams, D. B., Buka, S. L., Clark, M. A., Colby, S. M., Hitsman, B., Kazura, A. N., Lipsitt, L. P., Lloyd-Richardson, E. E., Rogers, M. L., Stanton, C. A., Stroud, L. R., & Niaura, R. S. (2009). Pirja e duhanit nga prindërit dhe fillimi i duhanpirjes tek adoleshentët: Perspektivë ndërbrezore mbi kontrollin e duhanit. *Pediatri*, 123(2), e274-e281. <https://doi.org/10.1542/peds.2008-2251>
13. Hanewinkel, R., Isensee, B., Sargent, J. D., & Morgenstern, M. (2011). Reklamata e cigareve dhe fillimi i duhanpirjes tek adoleshentët. *Pediatri*, 127(2), e271-e278. <https://doi.org/10.1542/peds.2010-2934>

14. Harakeh, Z., Engels, R. C. M. E., Vermulst, A. A., De Vries, H., & Scholte, R. H. J. (2007). Ndikimi i miqve të ngushtë dhe vëllezërve e motrave në duhanpirjen te adoleshentët: Studim gjatësor. *Psikologji dhe shëndet*, 22(3), 269-289. <https://doi.org/10.1080/14768320600843218>
15. HarrelL, J. S., Bangdiwala, S. I., Deng, S., Webb, J. P., & Bradley, C. (1998). Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë. *Revista e shëndetit te adoleshentëve*, 23(5), 271-279. [https://doi.org/10.1016/s1054-139x\(98\)00078-0](https://doi.org/10.1016/s1054-139x(98)00078-0)
16. Hill, K. G., Hawkins, J. D., Catalano, R. F., Abbott, R. D., & Guo, J. (2005). Ndikimet familjare në rrezikun e fillimit të përditshëm të duhanpirjes. *Revista e shëndetit te adoleshentëve*, 37(3), 202-210. <https://doi.org/10.1016/j.jadohealth.2004.08.014>
17. Lakon, C. M., Hipp, J. R., & Timberlake, D. S. (2010). Konteksti social i duhanpirjes tek adoleshentët: Perspektivë sistemore. *Gazeta Amerikane e Shëndetit Publik*, 100(7), 1218-1228. <https://doi.org/10.2105/ajph.2009.167973>
18. Mahabee-Gittens, E. M., Xiao, Y., Gordon, J. S., & Khoury, J. C. (2012). Rëndësia e vazhdueshme e faktorëve familjarë në sjelljen e duhanpirësit të të rinjve. *Hulumtim i nikotinës dhe duhanit*, 14(12), 1458-1466. <https://doi.org/10.1093/ntr/nts078>
19. Morgenstern, M., Sargent, J. D., Engels, R. C., Scholte, R. H., Florek, E., Hunt, K., Sweeting, H., Mathis, F., Faggiano, F., & Hanewinkel, R. (2013). Pirja e duhanit në filma dhe fillimi i duhanpirjes tek adoleshentët. *Gazeta Amerikane e Mjekësisë Parandaluese*, 44(4), 339-344. <https://doi.org/10.1016/j.amepre.2012.11.037>
20. Robalino, J. D., & Macy, M. (2018). Efektet e bashkëmoshatarëve në duhanpirje tek adoleshentët: A janë adoleshentët popullorë më me ndikim? *PLOS ONE*, 13(7), e0189360. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0189360>
21. Sargent, J. D., Beach, M. L., Adachi-Mejia, A. M., Gibson, J. J., Titus-Ernstoff, L. T., Carusi, C. P., Swain, S. D., Heatherton, T. F., & Dalton, M. A. (2005). Ekspozimi ndaj duhanpirjes në film: Lidhja e tij me fillimin e duhanpirjes tek adoleshentët amerikanë. *Pediatrici*, 116(5), 1183-1191. <https://doi.org/10.1542/peds.2005-0714>
22. Stoklosa, M., Pogorzalczyk, K., & Balwicki, U. (2021). Rritja e çmimit të cigareve, ndalimi i reklamave dhe paralajmërimet pikturale si përcaktues të fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Poloni. *Hulumtimi i nikotinës dhe duhanit*, 24(6), 820-825. <https://doi.org/10.1093/ntr/ntab262>
23. Tworek, C., Yamaguchi, R., Kloska, D. D., Emery, S., Barker, D. C., Giovino, G. A., O'Malley, P. M., & Chaloupka, F. J. (2010). Politikat e kontrollit të duhanit në nivel shtetëror dhe masat për ndërprerjen e duhanpirjes te të rinjtë. *Politikat shëndetësore*, 97(2-3), 136-144. <https://doi.org/10.1016/j.healthpol.2010.04.009>
24. Tyas, S. L., & Pederson, L. L. (1998). Faktorët psikosocialë që kanë të bëjnë me duhanpirjen tek adoleshentët: Shqyrtim kritik i literaturës. *Kontrrolli i duhanit*, 7(4), 409-420. <https://doi.org/10.1136/tc.7.4.409>
25. van Hasselt, M., Kruger, J., Han, B., Caraballo, R. S., Penne, M. A., Loomis, B., & Gfroerer, J. C. (2015). Marrëdhënia midis taksave të duhanit dhe duhanpirjes nga të rinjtë: Çfarë ndodhi pas rritjes së taksave federale për cigaret në SHBA më 2009? *Sjelljet e varësisë*, 45, 104-109. <https://doi.org/10.1016/j.addbeh.2015.01.023>
26. Unger, J. B., & Chen, X. (1999). Roli i rrjeteve sociale dhe pranueshmërisë së medias në parashikimin e moshës së fillimit të duhanpirjes. *Sjelljet e varura*, 24(3), 371-381. [https://doi.org/10.1016/s0306-4603\(98\)00102-6](https://doi.org/10.1016/s0306-4603(98)00102-6)

Shtojcë

Tabela A1.
Variablat

Emri i variablit	Përkufizimi
Variablat e varur	
Fillimi	Variabla e rremë që merr vlerën 1 nëse i anketuari ka filluar pirjen e duhanit dhe zero nëse jo
Kohëzgjatja	variabël = që ndërtohet bazuar në moshën e fillimit duke zbritur moshën minimale
Variabla kyçe e pavarur: Çmimi	
Çmimi konstant	Çmimi i një pakoje me 20 cigare Lucky Strike në Republikën e Kosovës i ulur me ndryshimin vjetor të CPI për cigare
LnConsPrice	Çmimi i një pakoje me 20 cigare Lucky Strike në Republikën e Kosovës, i ulur me ndryshimin vjetor të CPI për cigare, në formën e saj logaritmike natyrale.
Female_Inprice	Ndërveprimi i variablës së rreme duke marrë vlerën 1 nëse i anketuari është femër dhe regjistri i çmimit
Variabla të tjerë të pavarur me interes: masa e politikave që nuk kanë të bëjnë me çmime	
Lehtësia për t'u blerë	Variabla e rremë që merr vlerën 1 nëse i anketuari raporton se është mjaft lehtë të blihen cigaret
Refuzimi i shitjes	Variabla e rremë që merr vlerën 1 nëse të anketuarit i është refuzuar ndonjëherë shitja
Politika 2011	Variabla e rreme që merr vlerën 1 nëse pas vitit 2011, kur u miratuan ligjet për akcizën e duhanit dhe prodhimit, përpunimit dhe tregtimit.
Politika 2013	Variabla e rreme që merr vlerën 1 nëse pas vitit 2013, kur u miratua ligji për kontrollin e duhanit
Politika 2015	Variabla e rreme që merr vlerën 1 nëse pas vitit 2015, kur u miratua akzica kalendarike e duhanit
Variablat e kontrollit	
Gjinia	Variabla e rremë gjinore që merr vlerën 0 nëse i anketuari është mashkull dhe 1 nëse i anketuari është femër
Një prind duhanpirës	Ndryshorja e rreme që merr vlerën 1 nëse njëri ose të dy prindërit e të anketuarit janë duhanpirës
Miqtë duhanpirës	Ndryshorja e rreme që merr vlerën 1 nëse së paku gjysma e miqve më të ngushtë të të anketuarit janë duhanpirës
t	Tregon kohën e aktit të parë
t2	Tregon kohën nga akti i parë në të dytin
t3	Tregon kohën nga akti i dytë në të tretin

Shtojcë

Tabela A2.

Statistika përshkruese

Emri i variablit	Nr. of vëzh.	Nr. PSU	Mesatarja (Mean)	St. Dev.				
Fillimi	32,099	4,590	22.8%	0.0008				
% vlera 0	97.44%							
% vlera 1	2.56%	Mash-kull	Femër	mosha mesatare	Mosha mesatare në fillim			
		61.39%	38.61%	13.8	11.57			
Mosha në fillim	4,512	821	12.28	0.0724				
Përqindja e duhanpirësve sipas moshës në fillim	8 vjeç	9 vjeç	10 vjeç	11 vjeç	12 vjeç	13 vjeç	14 vjeç	15 vjeç
	3.24%	6.05%	8.16%	11.86%	21.68%	25.22%	11.70%	12.10%
Kohëzgjatja		4,580	6.517	0.016				
Çmimi konstant	32,099	4,590	4.630	0.0033				
Female_CPrice	32,099	4,590	2.345	0.039				
	Nr. of vëzh.	Nr. PSU	% 0	% 1				
Gjinia	32,099	4,589	47.04%	52.96%				
Një prind duhanpirës	31,745	4,541	50.15%	49.85%				
Miqtë duhanpirës	31,980	4,573	70.49%	29.51%				
Lehtësia për t'u blerë	31,755	4,542	83.64%	16.36%				
Refuzimi i shitjes	31,996	4,576	95.65%	4.35%				
Politika 2011	32,099	4,590	20.15%	79.85%				
Politika 2013	32,099	4,590	48.06%	51.94%				
Politika 2015	32,099	4,590	74.98%	25.02%				

www.tobacconomics.org